Tabela e Përputhshmërisë

Legjislacioni Europian	**Legjislacioni Shqiptar**
Titulli: Direktiva 2003/33/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 maj 2003, për përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me reklamimin dhe sponsorizimin e produkteve të duhanit ***Numri Celex. 32003L0033*** ***OJ L 152, 20.6.2003, p. 16***	**0.1 Projektligji "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit dhe produktet e lidhura me to"** **F – Plotësisht e harmonizuar** **P – Pjesërisht e harmonizuar** **N – Pa Harmonizuar** **n/a – jo relevante për përafrim** **Shkalla e përputhshmërisë : F (e plotë).**

1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**
Neni	**Teksti**	**Referenca**	**Neni**	**Teksti**	**Përputhshmëria**	**Komente**

Neni	**Teksti**	**Referenca**	**Neni**	**Teksti**	**Përputhshmëria**	**Komente**
Neni 1 **Objekti dhe fusha e zbatimit** **Pika 1**	1. Objektivi i kësaj direktive është përafrimi i ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me reklamimin e produkteve të duhanit dhe promovimin e tyre: a) në shtyp dhe në media të tjera të shkruara; b) në transmetimet radiofonike; c) në shërbimet e shoqërisë së informacionit; dhe d) përmes sponsorizimit të lidhur me duhanin, duke përfshirë shpërndarjen falas të produkteve të duhanit.	**0.1**	**Neni 1/dh**	1. Objekt i këtij ligji janë: dh) reklamimi, promovimi dhe sponsorizimi i produkteve të duhanit dhe produkteve të lidhura me to, në shtyp dhe botime të tjera të shtypura, në transmetimet radiofonike, në shërbimet e shoqërisë së informacionit, në komunikimet tregtare audiovizive, si dhe nëpërmjet sponsorizimit, përfshirë shpërndarjen falas të produkteve të duhanit dhe produkteve të lidhura me to;	**F**	**Plotësisht e harmonizuar**

Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Komente
Neni 1 Pika 2	Kjo direktivë ka për qëllim të sigurojë lëvizjen e lirë të mediave në fjalë dhe të shërbimeve të lidhura me to, si dhe të eliminojë pengesat për funksionimin e tregut të brendshëm.	**0.1**	**Neni 41/4**	4. Lidhur me dispozitat e Kreut VII të këtij ligji, autoriteti kompetent nuk kufizon dhe nuk ndalon lëvizjen e lirë të mediave ose të shërbimeve që janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji lidhur me reklamimin, promovimin dhe sponsorizimin e produkteve të duhanit. Kjo dispozitë zbatohet pa cenuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë.	**F**	**Plotësisht e harmonizuar**
Neni 2 Përkufizimet a)	Për qëllimet e kësaj direktive, zbatohen përkufizimet e mëposhtme: a) “produkte duhani” janë të gjitha produktet e synuara për tymosje, nuhatje, thithje ose përtypje, për sa kohë që ato përbëhen, qoftë edhe pjesërisht, nga duhani;	**0.1**	**Neni 4/50**	Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 50. "Produkte duhani" nënkupton produktet që konsumohen dhe përbëhen, qoftë edhe pjesërisht, nga duhani, pavarësisht nëse është i modifikuar gjenetikisht ose jo.	**F**	**Plotësisht e harmonizuar**
Neni 2/b) Pika	b) "reklamim” është çdo formë e komunikimit tregtar me qëllim ose efekt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të promovimit të një produkti duhani;	**0.1**	**Neni 4/59**	59. “Reklamim” është çdo formë komunikimi tregtar ose jotregtar, që ka për qëllim ose efekt të drejtpërdrejtë, të tërthortë ose të fshehtë promovimin e një produkti duhani ose produkti të lidhur me të, përfshirë komunikimin që përdor emrin, markën tregtare, logon, simbolin ose elementin tjetër dallues të lidhur me këto produkte.	**F**	**Plotësisht e harmonizuar**
Neni 2/c)	c) "sponsorizim" është çdo formë e kontributit publik ose privat për çdo ngjarje, veprimtari ose individ, me qëllim ose efekt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të promovimit të një produkti duhani;	**0.1**	**Neni 4/61**	61. "Sponsorizim" nënkupton çdo formë të kontributit publik ose privat, për çdo ngjarje, veprimtari ose person fizik, me qëllim ose efekt të drejtpërdrejtë apo të tërthortë apo të fshehtë të promovimit të një produkti duhani.	**F**	**Plotësisht e harmonizuar**
Neni 2/d)	d) “shërbime të shoqërisë së informacionit” janë shërbimet sipas kuptimit të nenit 1, paragrafi 2 të Direktivës 98/34/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 22 qershor 1998, “Për përcaktimin e një procedure për ofrimin e informacionit në fushën e standardeve dhe rregulloreve teknike dhe të rregullave	**0.1**	**Neni 4/63**	63. "Shërbime të shoqërisë së informacionit" janë shërbimet, që ofrohen përkundrejt pagesës, në distancë, nëpërmjet mjeteve elektronike dhe me kërkesë individuale të marrësit të shërbimit.	**F**	**Plotësisht e harmonizuar**

Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Komente
	për shërbimet e shoqërisë së informacionit"[1]					
Neni 3 **Reklamimi në mediat e shkruara dhe shërbimet e shoqërisë së informacionit** **Pika 1**	1. Reklamimi në shtyp dhe në media të tjera të shkruara do të kufizohet në botimet e synuara ekskluzivisht për profesionistët e tregtisë së duhanit dhe në botimet e shtypura dhe të botuara në vende të treta, kur këto botime nuk janë të synuara kryesisht për tregun e Komunitetit. Reklamimet e tjera në shtyp dhe në media të tjera të shkruara janë të ndaluara.	**0.1**	**Neni 30/1** **Neni 30/2**	1. Reklamimi i produkteve të duhanit dhe produkteve të lidhura me to në shtyp dhe botimet e tjera të printuara kufizohet vetëm në: a) botimet e destinuara ekskluzivisht për profesionistët e tregtisë së duhanit dhe produkteve të lidhura me to; dhe b) botimet e printuara e të botuara në shtete të treta, me kusht që ato botime të mos jenë të destinuara kryesisht për tregun shqiptar. 2. Çdo reklamim i cili nuk lejohet sipas pikës 1 të këtij neni ndalohet gjithashtu në shërbimet e shoqërisë së informacionit.	**F**	**Plotësisht e harmonizuar**
Neni 3 **Pika 2**	2. Reklamimi i palejuar në shtyp dhe në media të tjera të shkruara nuk lejohet as në shërbimet e shoqërisë së informacionit.	**0.1**	**Neni 30/3**	3. Çdo formë tjetër reklamimi e produkteve të duhanit dhe produkteve të lidhura me to në median e shkruar ose në shërbimet e shoqërisë së informacionit ndalohet.	**F**	**Plotësisht e harmonizuar**
Neni 4 **Reklamimi dhe sponsorizimi në radio** **Pika 1**	1. Të gjitha format e reklamimit të produkteve të duhanit në radio janë të ndaluara.	**0.1**	**Neni 31/1**	1. Ndalohen të gjitha format e reklamimit radiofonik dhe audioviziv për produktet e duhanit dhe produkteve të lidhura me to ndalohen.	**F**	**Plotësisht e harmonizuar**
Neni 4 **Pika 2**	2. Programet radiofonike nuk sponsorizohen nga ndërmarrjet, veprimtaria kryesore e të cilave është prodhimi ose shitja e produkteve të duhanit.	**0.1**	**Neni 31/2**	2. Programet radiofonike nuk mund të sponsorizohen nga ndërmarrje, aktiviteti kryesor i të cilave është prodhimi ose shitja e produkteve të duhanit. Programet radiofonike dhe programet audiovizive nuk mund të sponsorizohen nga shoqëri, persona apo sipërmarrje, veprimtaria kryesore e të cilave është prodhimi ose tregtimi i produkteve të duhanit dhe produkteve të lidhura me to.	**F**	**Plotësisht e harmonizuar**
Neni 5 **Sponsorizimi i ngjarjeve** **Pika 1**	1. Ndalohet sponsorizimi i ngjarjeve ose veprimtarive që përfshijnë ose zhvillohen në disa shtete anëtare ose që kanë efekte ndërkufitare.	**0.1**	**Neni 33/1**	1. Ndalohet sponsorizimi i ngjarjeve ose aktiviteteve që zhvillohen në Republikën e Shqipërisë ose që kanë efekte ndërkufitare, kur sponsorizimi ka si qëllim ose efekt, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, promovimin e produkteve të duhanit dhe produkteve të	**F**	**Plotësisht e harmonizuar**

[1] Gazeta Zyrtare L 204, 21.7.1998, fq. 37. Direktiva e ndryshuar me Direktivën 98/48/KE (Gazeta Zyrtare L 217, 5.8.1998, f. 18).

Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Komente
				lidhura me to.		
Neni 5 Pika 2	2. Ndalohet shpërndarja falas e produkteve të duhanit në kontekstin e sponsorizimit të ngjarjeve të përmendura në paragrafin 1, që kanë për qëllim ose efekt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë promovimin e këtyre produkteve.	**0.1**	**Neni 33/2**	2. Ndalohet çdo shpërndarje falas e produkteve të duhanit dhe të produkteve të lidhura me to, në kontekstin e sponsorizimit të ngjarjeve të referuara në pikën 1 të këtij neni, kur ajo shpërndarje ka si qëllim ose efekt, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, promovimin e produkteve të tilla.	**F**	**Plotësisht e harmonizuar**
Neni 6 Raportimi	Brenda datës 20 qershor 2008, Komisioni i paraqet Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social një raport për zbatimin e kësaj direktive. Ky raport shoqërohet me të gjitha propozimet për ndryshime në këtë direktivë që Komisioni i gjykon të nevojshme.	**0.1**			**n/a**	**jo relevante për përafrim**
Neni 7 Sanksionet dhe zbatimi Paragrafi 1	Shtetet Anëtare përcaktojnë rregullat mbi sanksionet e zbatueshme për shkeljet e dispozitave kombëtare të miratuara në përputhje me këtë direktivë dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar zbatimin e tyre. Sanksionet e parashikuara duhet të jenë efektive, proporcionale dhe shtrënguese. Shtetet anëtare njoftojnë Komisionin për këto rregulla maksimumi deri më datën e specifikuar në nenin 10 dhe e njoftojnë atë pa vonesë për çdo ndryshim të mëvonshëm që ka ndikim mbi to.	**0.1**	**Nenii 40 (1) d**	1. Çdo shkelje e dispozitave të këtij ligji dhe e akteve nënligjore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet si më poshtë: d) shkelja e neneve 30, 31 dhe 33 (Kreu VII, reklamimi, promovimi dhe sponsorizimi) dënohet me gjobë 3 000 000 (tre milionë) lekë, për subjektin e tatueshëm të veprimtarisë së reklamës, medias së shkruar, transmetimit televiziv ose radiofonik, ose të shërbimit të shoqërisë së informacionit, ose ndaj subjektit prodhues, importues a tregtues të produkteve të duhanit që sponsorizon veprimtaritë e ndaluara;	**F**	**Plotësisht e harmonizuar**
Neni 7 Paragrafi 2	Këto rregulla përfshijnë dispozita që sigurojnë që personat ose organizatat që, sipas legjislacionit kombëtar, mund të justifikojnë një interes legjitim për ndalimin e reklamimit, sponsorizimit ose çështjeve të tjera të	**0.1**	**Neni 40/7**	7. Personat fizikë dhe juridikë, si dhe organizatat e shoqërisë civile, të cilat, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, mund të justifikojnë interes legjitim në ndalimin e reklamimit, promovimit, sponsorizimit ose çështjeve të tjera në papajtueshmëri me Kreun	**F**	**Plotësisht e harmonizuar**

Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Komente
	papajtueshme me këtë direktivë, mund të ndërmarrin veprime ligjore kundër reklamimit ose sponsorizimit ose ta sjellin këtë reklamim ose sponsorizim në vëmendjen e një organi administrativ kompetent për t'u shprehur mbi ankesat ose për të nisur procedurat e duhura ligjore.			VII të këtij ligji, kanë të drejtë: a) të ndërmarrin veprime juridike kundër reklamimit, promovimit ose sponsorizimit të tillë; ose b) të paraqesin çështjen para organit administrativ kompetent, qoftë për shqyrtimin e ankesave, qoftë për fillimin e procedurave juridike të duhura.		
Neni 8 Lëvizja e lirë e produkteve dhe shërbimeve	Shtetet anëtare nuk ndalojnë ose kufizojnë lëvizjen e lirë të produkteve ose shërbimeve që janë në përputhje me këtë direktivë.	**0.1**	**Neni 41/4**	4. Lidhur me dispozitat e Kreut VII të këtij ligji, autoriteti kompetent nuk kufizon dhe nuk ndalon lëvizjen e lirë të mediave ose të shërbimeve që janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji lidhur me reklamimin, promovimin dhe sponsorizimin e produkteve të duhanit. Kjo dispozitë zbatohet pa cenuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë.	**F**	**Plotësisht e harmonizuar**
Neni 9 Referencat ndaj Direktivës 98/43/KE	Referencat ndaj Direktivës së anuluar 98/43/KE interpretohen si referenca ndaj kësaj direktive.				**n/a**	**jo relevante për përafrim**
Neni 10 Zbatimi Paragrafi 1	1. Shtetet anëtare miratojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me këtë direktivë maksimumi deri më 31 korrik 2005. Ato njoftojnë menjëherë Komisionin për këtë gjë. Kur miratojnë këto masa, shtetet anëtare i referohen kësaj direktive ose i shoqërojnë ato me një referencë të tillë në rastin e botimit zyrtar të tyre. Mënyrat e bërjes së kësaj reference përcaktohen nga vetë shtetet anëtare.				**n/a**	**jo relevante për përafrim**
Neni 11 Hyrja në fuqi	Kjo Direktivë hyn në fuqi njëzet ditë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.				**n/a**	**jo relevante për përafrim**

Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Komente
Neni 12 Marrësit	Kjo direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.				**n/a**	**jo relevante për përafrim**